



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË PËR KOMUNITETE DHE KTHIM PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Vlera e pasurisë kapitale e prezantuar në PFV ishte mbivlerësuar për 775,419€ si rezultat i mos bartjes së pasurisë në komunat përkatëse;
- A1 MKK ka paguar shpenzime në vlerë prej 214,750€ në kategorinë ekonomike joadekuate;
- B2 MKK gjatë vitit 2022 kishte realizuar pagesa në vlerë prej 108,799€ për 20 punonjës për të cilët nuk ka dëshmi për vijueshmëri në punë.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Në kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MKK kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri për Komunitete dhe Kthim është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë më shumë fokus kanë të bëjnë me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve, pagesën e zyrtarëve sipas Marrëveshjes së Brukselit në mungesë të evidencave për vajtje-ardhje në punë. Në anën tjetër, mangësitë lidhur me menaxhimin e regjistrit të pasurive kishin ndikuar në mbivlerësimin e tyre. Po ashtu, kërkohet fokus në trajtimin e rasteve të mospajtueshmërisë lidhur me vonesën në realizimin e projektit për ndërtimin e shtëpive, si dhe mangësitë të cilat kanë përcjellur procesin e inventarizimit të pasurive

Ky raport ka rezultuar me pesë (5) rekomandime, prej tyre një (1) rekomandim është i ri, përderisa katër (4) janë të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Mbivlerësimi i pasurisë kapitale

##### Gjetja

Neni 12 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton mënyrën e regjistrimit, kategorizimit dhe kalimit të pronësisë me rastin e blerjes apo ndërtimit të pasurisë përmes bashkëfinancimit. Tutje, neni 13 i kësaj rregullore përcakton se "Të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim. Më tej, sipas nenit 6.1 'Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Për më tepër, neni 22 i kësaj rregullore përcakton metodën e zhvlerësimit të pasurive, normën si dhe llogaritjen bazuar në natyrën e pasurisë.

Vlera e prezantuar e pasurisë kapitale dhe jo kapitale në PFV ishte mbivlerësuar për 775,419€. si rezultat i mos bartjes së pasurive te pala përfituese dhe kategorizimit jo të drejtë.

Çështjet që kanë ndikuar këtë gjendje janë shpalosur, si në vijim:

- Për projektin "Ndërtimi i sistemit për pastrimin e ujërave të ndotura në vendbanimet Gazivodë dhe Velibreg' një (1) transaksion i testuar në vlerë prej 417,236€, figuron në regjistrin e Ministrisë e klasifikuar si investim në vijim ndërsa pranimi teknik i projektit ishte bërë më 04.11.2022. Nuk ishte bërë bartja te pala përfituese, me ç'rast regjistrat ishin mbivlerësuar për të njëjtën shumë;
- Për projektin "'Ndërtimi i sallës sportive' në fshatin Biti e lartë - Komuna e Shtërpçës, tre (3) transaksione të testuara në vlerë totale

prej 155,318€ ishin klasifikuar si investim në vijim, ndërsa pranimi teknik i projektit ishte bërë më 23.10.2023. Nuk ishte bërë bartja te pala përfituese, me ç'rast regjistrat ishin mbivlerësuar për të njëjtën shumë;

- Për projektin "Ndërtimi i sallës pranë kishës Sveti Nikolla' në fshatin Banjskë - Komuna e Vushtrisë, dy (2) transaksione të testuara në vlerë prej 48,691€ ishin klasifikuar si investim në vijim, ndërsa pranimi teknik i projektit ishte bërë më 31.08.2023. Nuk ishte bërë bartja te pala përfituese, me ç'rast regjistrat ishin mbivlerësuar për të njëjtën shumë;
- Për projektin "Renovimi i shtëpisë Marija Novakovic dy (2) transaksione të testuara në vlerë prej 4,175€ ishin klasifikuar si investim në vijim, ndërsa pranimi teknik i projektit ishte bërë më 06.05.2022. Nuk ishte bërë bartja te pala përfituese, me ç'rast regjistrat ishin mbivlerësuar për të njëjtën shumë;
- Për projektin "Mbështetje për zgjidhje të qëndrueshme për banorët e qendrave kolektive në Kosovë" dy (2) transaksione të testuara në vlerë prej 149,999€ ishin regjistruar si pasuri në SIMFK. Pagesat kishin të bënin me pagesën e qirasë dhe mbështetje teknike. Rrjedhimisht, regjistri i pasurisë ishte mbivlerësuar për këtë vlerë.

Mbivlerësimi i regjistrave të pasurisë dhe mangësitë e identifikuar kanë ardhur si rezultat i pakujdesisë dhe funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në këtë fushë.

#### **Ndikimi**

Mos bartja e pronësisë së pasurive tek komunitat përfituese si dhe regjistrimi i pasurisë e cila nuk i plotëson kriteret për kapitalizim ndikon në paraqitje jo të drejtë dhe mbivlerësim të vlerës së pasurisë në PFV.

#### **Rekomandimi B1**

Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë masat e duhura për të siguruar bartjen e plotë të pronësisë së pasurisë tek komunitat dhe njëkohësisht të bëjë azhurnimin e regjistrat të pasurisë duke i larguar investimet në vijim të cilat tashmë i takojnë përfituesve tjerë, po ashtu të largoj nga regjistrat e pasurisë shpenzimet operative në mënyrë që pasuritë të prezantohen drejt dhe saktë në PFV e vitit 2023. Për më tepër, të siguroj se aplikohet një analizë e mirëfilltë e regjistrat të pasurive, në mënyrë që saldo e bartur në vitin vijues të ofrojë informata të sakta.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve**

##### **Gjetja**

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 shpenzimet duhet të realizohen dhe të evidentohen në kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i Udhëzimit Administrativ (UA) 19/2009 për planin kontabël kërkon nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Ministria gjatë vitit 2023 ka ekzekutuar shpenzime në vlerë prej 214,750€ nga kategoria investime kapitale për furnizim me material ndërtimor për përfitues individual, përderisa këto shpenzime për nga natyra i takonin kategorisë subvencione dhe transfere.



Keqklasifikimi ishte ndikuar nga buxhetimi jo adekuat i shpenzimeve.

**Ndikimi** Pagesat e kryera nga kodet joadequate të shpenzimeve kanë ndikuar në mbivlerësimin e investimeve kapitale dhe nënvlerësimin e subvencioneve, rrjedhimisht në paraqitjen jo të saktë dhe jo të drejtë të shpenzimeve në PFV.

**Rekomandimi A1** Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme nga zyrtarët përgjegjës në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adequate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## **Çështja B2 - Kompensimi i punonjësve pa vijueshmëri të plotë në punë**

**Gjetja** Neni 9 i Rregullores (QRK) Nr.1072022 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve”, përcakton se “Çdo zyrtar publik është i obliguar që të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, varësisht se cilën ka në përdorim institucioni “.

Me vendimin nr. 06/39 të datës 22.07.2015, ministria ishte e obliguar t' i sistemojë 20 punonjës të komunitetit serb me qëllim të integritetit të tyre në sistemin e Republikës së Kosovës. Këta punonjës nuk kishin punuar asnjëherë për MKK që nga koha e nënshkrimit të aktemërimeve. Rrjedhimisht, sipas konfirmimeve nga zyrtarët relevant, për të njëjtit nuk kishte dëshmi të vijueshmërisë në punë. Shpenzimi për vitin 2023 për këtë kategori ishte 108,799€.

Kjo dukuri po vazhdon të jetë prezente ndër vite edhe pse është raportuar në vazhdimësi nga raportet tona të auditimit. Ministria ende nuk ka arritur të ndërmarrë masa konkrete në sistemin, angazhimin dhe monitorimin e kësaj kategorie të të punësuarve.

**Ndikimi** Pagesat e punonjësve në mungesë të dëshmime për vijueshmëri në punë dhe në mungesë të angazhimit për kryerjen e detyrave zyrtare, konsiderohen si pagesa të parregullta dhe dëmtojnë buxhetin e ministrisë.

**Rekomandimi B2** Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 2,738,420€, prej tyre ishin shpenzuar 1,147,880€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me mbështetjet financiare për furnizim me material ndërtimor, ndërtimin dhe renovimin e ndërtesave të banimit për komunitetet jo shumicë, si dhe transferet për organizatat ndërkombëtare për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive për personat e kthyer si dhe pagesat për kompenzimin e inflacionit.

#### Çështja B3 - Vonesat në realizimin e punimeve

##### Gjetja

Bazuar në kontratën për projektin "Ndërtimi dhe renovimi i shtëpive për të kthyerit dhe familjeve në nevojë" ndërmjet MKK-së dhe OE, lëndë e të cilës ishte ndërtimi i 150 shtëpive dhe 50 renovime të objekteve, përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e palëve lidhur me implementimin e kontratës. Kontrata ishte 3 vjeçare ishte përfunduar me 22.10.2023. Kushtet e veçanta të kontratës përcaktojnë që kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 45 ditëve sipas planit dinamik të caktuar nga AKK.

Për vitin 2023 ishte planifikuar që të ndërtohen 50 shtëpi si dhe të rinovohen 50 shtëpi për të kthyerit dhe familjet në nevojë nga komunitetet jo shumicë. Përderisa, gjatë vitit 2023 MKK kishte parashtruar 30 kërkesa për fillim të ndërtimit të shtëpive dhe një (1) kërkesë për renovim të shtëpisë. Afati i paraparë për implementimin e kontratës kishte përfunduar pa u finalizuar punimet e planifikuara.

Edhe pse numri i shtëpive për ndërtim dhe renovim ishte shumë më i ultë se sa ishin kontraktuar, asnjëra nga këto shtëpi nuk ishte finalizuar, përkatësisht nuk ishte kryer pranimi teknik.

Prej 31 shtëpive të dakorduara vetëm njëmbëdhjetë (11) shtëpi ishin në fazën finale të ndërtimit, por nuk ishin përfunduar, dhjetë (10) shtëpi të tjera ishin në fazën e ndërtimit të vrazhdë, përderisa për dhjetë (10) shtëpi të tjera MKK ishte kërkuar të mos fillohet ndërtimi fare për shkak të vonesave në fillim të punimeve nga OE dhe afatit të përfundimit të kontratës.

Nga testimi i pesë (5) mostrave ne kemi identifikuar që punimet për ndërtimin e shtëpive me vlerë totale prej 92,042€ nuk ishin përfunduar brenda afatit të paraparë. Duke ju referuar raportit të menaxherit të kontratës vonesat ishin nga 60 ditë pune deri në 97 ditë pune. Gjatë ekzaminimit në terren (prill 2024) këto shtëpi ende nuk ishin përfunduar.

Edhe pse me kohë menaxherët e kontratave kishin raportuar MKK-në që implementimi i projektit nuk po zbatohet sipas planit dinamik, MKK nuk kishte shkëputur kontratën me OE. Me vonesë, MKK kishte dërguar dy vërejtje ndaj OE si dhe në nëntor të vitit 2023 kishte marrë vendim për konfiskim të sigurimit të ekzekutimit, gjë e cila nuk ishte ekzekutuar pasi që ishte caktuar masa e përkohshme e sigurimit nga Gjykata komerciale.

Kjo kishte ndodhur për shkak të planifikimit jo të duhur projekteve si dhe mungesës së marrjes së masave me kohë ndaj OE.

- Ndikimi** Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë që MKK të mos arrijë objektivat e përcaktuara dhe njëherësh mund të shkaktojnë vështirësi buxhetore për vitet pasuese.
- Rekomandimi B3** Ministri duhet të sigurojë se bëhet një planifikim më real i projekteve duke marrë për bazë ndër tjerash edhe rrethanat që mund të ndikojnë në realizimin e tyre. Po ashtu, në rastet kur ka ngecje në realizimin e projektit të ndërrmerren veprime parandaluese në pajtim me kontratën dhe ligjin.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 1,769,717€, pasurive jokatitale është 36,763€, si dhe e stoqeve 13,388€.

### Çështja B4 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe mos harmonizimi i regjistrave

**Gjetja** Sipas nenit 18.1 të Rregullores - Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, "Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare". Neni 17.2 përcakton që " Zyrta i Pranimi/Logjistikës nuk do të ketë të drejtën të jetë një prej anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Pasurisë jo Financiare dhe Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare; si dhe të vendos në çështjet që janë të ndërlidhura me tjetërsimin e pasurive.

Në MKK është bërë inventarizimi i pasurisë për vitin 2023, por në këtë proces ishte përfshirë vetëm pasuria në përdorim nga zyrtarët të cilat ndodheshin fizikisht nëpër zyrat e MKK-së. Procesi i inventarizimit nuk kishte përfshirë të gjithë pasurinë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të ministrisë. Për më tepër, raporti i inventarizimit nuk është harmonizuar me regjistrin e përgjithshëm të pasurisë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos ndërrmarjes së masave të mjaftueshme në pajtim me kërkesat e rregullores që ndërlidhen me detyrat e komisionit të inventarizimit.

**Ndikimi** Mangësitë e identifikuar pamundësojnë krahasimin e rezultateve dhe ndikojnë në identifikimin e pasurive të cilat nuk janë në pronësi të MKK-se dhe pasurive që duhet të largohen nga regjistrat duke mundësuar azhurnimin e regjistrit me informata të sakta dhe të plota lidhur me pasurinë në posedim.

**Rekomandimi B4** Ministri duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë ka informata të plota për të gjithë pasuritë në përdorim dhe në pronësi të ministrisë, dhe pas inventarizimit duhet të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive për të korrigjuar gabimet e mundshme në regjistrin e pasurive, në mënyrë që prezantimi i pasurive në PFV-të e vitit 2024 të jetë i saktë.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

| Përshkrimi                  | Buxheti fillestar | Buxheti final <sup>5</sup> | 2023<br>Shpenzimet | 2022<br>Shpenzimet | 2021<br>Shpenzimet |
|-----------------------------|-------------------|----------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| <b>Burimet e fondeve</b>    | <b>4,393,340</b>  | <b>7,419,142</b>           | <b>5,479,908</b>   | <b>2,871,886</b>   | <b>4,101,464</b>   |
| Grante Qeveritare - Buxheti | 4,393,340         | 7,419,142                  | 5,479,908          | 2,871,886          | 4,101,464          |
| Donacionet e jashtme        | 0                 | 0                          | 0                  | 0                  | 0                  |

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 3,025,802€ apo rreth 69%. Ky ndryshim është rezultat i rritjes të buxhetit për suvencione dhe transfere me vendim të Qeverisë.

Në vitin 2023 MKK kishte shpenzuar 5,479,925€ apo rreth 74% të buxhetit final, me një performancë më të ulët në krahasim me vitin 2022 ku realizimi i buxhetit ishte 86%.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

| Përshkrimi                                             | Buxheti fillestar | Buxheti final    | 2023<br>Shpenzimet | 2022<br>Shpenzimet | 2021<br>Shpenzimet |
|--------------------------------------------------------|-------------------|------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| <b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b> | <b>4,393,340</b>  | <b>7,419,142</b> | <b>5,479,908</b>   | <b>2,871,886</b>   | <b>4,101,464</b>   |
| Pagat dhe mëditjet                                     | 802,823           | 828,625          | 828,625            | 700,827            | 726,367            |
| Mallrat dhe shërbimet                                  | 273,517           | 273,517          | 222,503            | 201,869            | 230,858            |
| Komunalitë                                             | 17,000            | 17,000           | 4,089              | 3,940              | 4,160              |
| Subvencionet dhe transferet                            | 300,000           | 3,561,580        | 3,276,810          | 62,924             | 73,329             |
| Investimet Kapitale                                    | 3,000,000         | 2,738,420        | 1,147,880          | 1,902,326          | 3,066,749          |

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar tek kategoria e pagave dhe mëditjeve kishte rritje prej 26,000€ me vendim të Qeverisë. Buxheti final ishte shpenzuar në nivel 100%. Ky realizim ishte i ndikuar nga miratimi i Ligjit të pagave.


Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte realizuar rreth 78% ndërkohë që nuk kishte lëvizje buxhetore gjatë vitit për këtë kategori.

Buxheti final për shpenzime komunale deri në fund të vitit ishte realizuar rreth 24% Shpenzimi i ulët në këtë kategori ishte si rezultat i pagesës së shpenzimeve komunale nga ana e MAPL-së.

Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin ishte rritur me vendim të Qeverisë në vlerë prej 3,000,000€ për masën 1.9 për mbështetje të punësimit të personave nga komunitetet jo shumicë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Realizimi i buxhetit në fund të vitit ishte rreth 92%. Po ashtu, me vendim të Qeverisë nga mjetet e kursyera nga Projektet për komunitet janë transferuar në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve vlera prej 261,580€. Ndërsa sa i përket masës 1.9, nga kategoria subvencione dhe transfere, deri në fund të vitit ishin shpenzuar mjete në vlerë prej 2,989,861€.

Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 261,580€, apo rreth 9%, me vendim të Qeverisë për kursime buxhetore. Realizimi i buxhetit final për këtë kategori ishte 42%. Shpenzimi i ulët në këtë kategori ishte si rezultat i mos realizimit të planit për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive për komunitetet jo shumicë.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat sipas projeksioneve të MF ishin në vlerë prej 1869€. MKK nuk ka të hyra të rregullta. Përderisa pranimet e vitit 2023 kishin të bënin me konfiskimin e sigurisë së ekzekutimit nga OE.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**


| Përshkrimi                | Buxheti<br>fillestar | Buxheti<br>final | 2023<br>Pranimet | 2022<br>Pranimet | 2021<br>Pranimet |
|---------------------------|----------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| <b>Totali i të hyrave</b> | <b>1,869</b>         | <b>1,869</b>     | <b>11,645</b>    |                  | <b>2,778</b>     |
| Të hyrat jo tatimore      | 1,869                | 1,869            | 11,645           |                  |                  |
| Të hyrat tjera            | 0                    | 0                |                  |                  | 2,778            |

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të MKK ka rezultuar në tetë (8) rekomandime. MKK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Po ashtu, MKK ka dorëzuar raportin për progresin në zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, katër (4) rekomandime janë zbatuar si dhe katër (4) nuk janë zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2022                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Veprimet e ndërmarra                                                          | Statusi                 |
|----|-------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|
| 1. | Baza për opinion  | Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë masat e duhura për të siguruar bartjen e plotë të pronësisë së pasurisë tek komunat dhe njëkohësisht të bëjë azhurnimin e regjistrit të pasurisë duke i larguar investimet në vijim të cilat tashmë i takojnë përfituesve tjerë, po ashtu të largoj nga regjistrat e pasurisë shpenzimet operative në mënyrë që pasuritë të prezantohen drejt dhe saktë në PFV e vitit 2023. Për më tepër, të siguroj se aplikohet një analizë e mirëfilltë e regjistrit të pasurive, në mënyrë që saldo e bartur në vitin vijues të ofrojë informata të sakta. | Ne kemi evidentuar raste të reja të mos bartjes së pasurisë gjatë vitit 2023. | Nuk ka filluar zbatimin |



|    |                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                                               |                        |
|----|--------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|
| 2. | Baza për opinion                     | Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.                                                                                                                                                         | Edhe gjatë vitit aktual është gjendje e njëjtë.                                                                                               | Nuk ka filluar zbatimi |
| 3. | Baza për opinion                     | Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave se raportimi mujor i faturave të papaguara paraqet gjendjen e saktë të tyre me qëllim që në PFV të shpaloset vlera e saktë e obligimeve.                                                                                                                                                                | Rekomandimi është marrë parasysh dhe gjatë vitit aktual raportimi nuk është përcjellë me parregullsi.                                         | I zbatuar              |
| 4. | Baza për konkluzion                  | Ministri duhet të sigurojë përmes personave përgjegjës që komisioni i vlerësimit kryen vlerësimin në pajtueshmëri të plotë me kërkesat që rrjedhin nga aktet ligjore në fuqi.                                                                                                                                                                                     | Nuk janë hasur raste të tilla gjatë auditimit të vitit aktual.                                                                                | I zbatuar              |
| 5. | Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë | Ministri duhet të sigurojë se shfrytëzimi i automjeteve zyrtare të ministrisë bazohet në vendimin e Qeverisë. Për rastet specifike Ministri duhet të adresoj kërkesën e arsyeshme për aprovim tek Qeveria për shfrytëzimin e veturave jashtë orarit të rregullt të punës. Po ashtu, të ketë informata të plota sa i përket përdorimit të tyre për qëllime zyrtare | Qeveria me datë 22.11.2023 kishte marrë vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë për përdorimin e veturave zyrtare.        | I zbatuar              |
| 6. | Subvencionet dhe transferet          | Ministri duhet të sigurojë se zyrtarët për monitorim të projekteve të financuara nga subvencionet dhe transferet kanë njohuri të mjaftueshme për monitorimin e tyre duke siguruar raportim financiar dhe narativ për shpenzimet e ndodhura nga përfituesit.                                                                                                       | Nuk janë hasur raste të tilla gjatë auditimit të vitit aktual.                                                                                | I zbatuar              |
| 7. | Investimet kapitale                  | Ministri duhet të sigurojë se bëhet një planifikim më real i projekteve duke marrë për bazë ndër tjerash edhe rrethanat që mund të ndikojnë në realizimin e tyre. Po ashtu, përmes menaxherëve përkatës të sigurojë mbikëqyrje të duhur gjatë realizimit të tyre.                                                                                                 | Vonesa në realizimin e projekteve ishin hasur edhe gjatë auditimit të vitit aktual. Përdorimi i projektet e vitit paraprak kishin përfunduar. | Nuk ka filluar zbatimi |

|    |          |                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                        |                        |
|----|----------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|
| 8. | Pasuritë | Ministri duhet të sigurojë se pas inventarizimit duhet të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive për të korigjuar gabimet e mundshme në regjistrin e pasurive, në mënyrë që prezantimi i pasurive në PFV e vitit 2023 të jetë i saktë. | Sfida lidhur me inventarizimin dhe harmonizimin e regjistrave të pasurisë e kishin përcjellë ministrinë edhe këtë vit. | Nuk ka filluar zbatimi |
|----|----------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm




Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Neslihane Mati, Udhëheqëse e ekipit



Fatbardha Jashari, Anëtare e ekipit



Valbona Tolaj, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

DALESE - IZLAZNA - OUTGOING  
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministartstvo Lokalne Samouprave / Administration  
Ministry of Local Government Administration

Nr.  
Bc. 900-87/3  
Data  
Date: 05.06.2024



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

KATEGORIA/DOKUMENTI  
BUDORPRAVLJENJE/DOKUMENT  
DATE/RECEIVING/UNITED: 6-06-2024

| Niveli Org.<br>Org. Jedini.<br>Org. Unit | Shifra klasif.<br>Klasif. Kod<br>Class. Code | Nr. Prot.<br>Br. Prot.<br>Prot. No. | Nr. faqeve<br>Br. Stranica<br>No. Pages |
|------------------------------------------|----------------------------------------------|-------------------------------------|-----------------------------------------|
| 03                                       | 47                                           | 776                                 | 1                                       |

## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Prishtinë, 30.05.2024

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Elbert Krasniqi

Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

**Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

**Opinionit i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinion i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.